



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:079539

Datë: 27.05.2022

Numri i dokumentit: 03063535

Pml.nr.127/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare, Agim Maliqi dhe Mejreme Memaj, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarve: A.H., E.H1., S.H2., A.M., A.B., H.Sh., B.S., N.H., R.H., S1.H1., S.S., secili veç e veç për shkak të veprës penale të marrja e ryshfetit në vazhdimësi nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 e 81 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe të dënuarit A1.B1., J.T.. dhe Z.Sh., për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të dënuarve dhe kërkesat e të dënuarve: A.H., avokat Mahmut Halimi, E.H1., av. Kada Bunjaku-Përçuku, S.H., av. Shefqet Ibrahim, A.M., A.B., H.Sh., av. Lutfi Tahiri, B.S., N.H., av. Ahmet Tahiri, R.H., av. Visar Rrecaj, S1.H1., av. Kadri Osaj, S.S., av. Mile Markoviq, A1.B1., av. Tahir Rrecaj dhe Z.Sh., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.69/2017 të datës 30.06.2021, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.405/2021 të datës 08.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më 26 prill 2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve dhe kërkesat e të dënuarve A.H., E.H1., S.H2., A.M., A.B., H.Sh., B.S., N.H., R.H., S1.H1., S.S., A1.B1., J.T.. dhe Z.Sh., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.69/2017 të datës 30.06.2021, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.405/2021 të datës 08.11.2021.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin P.nr.69/2017 e datës 30.06.2021, të dënuarin A.H., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale marrja së ryshfetit në vazhdimësi nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 e 81 të KPRK-së (dispozitivi nën pikën I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII dhe IX), dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 19.12.2016 e deri më datë 19.01.2017, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 3.000 (tremijë) euro. Të dënuarin A1.B1., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale të marrja e ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së (pika X e dispozitivit) dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 19.12.2016 e deri më datë 31.12.2016, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) euro. Të dënuarin A.B., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit në vazhdim nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 e 81 të KPRK-së (pika VI dhe VII, të dispozitivit) dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 19.12.2016 e deri më datë 31.12.2016, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) euro. Të dënuarin A.M., e ka shpallur fajtor për veprën penale marrja e ryshfetit në vazhdimësi nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 e 81 të KPRK-së (pikat IV dhe V të dispozitivit), i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 19.12.2016 e deri më datë 31.12.2016, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) euro. Të dënuarin B.S., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit në vazhdimësi nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 e 81 të KPRK-së (pikat XI dhe XII të dispozitivit) dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 19.12.2016 e deri më datë 31.12.2016, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) euro. Të dënuarin E.H1., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit në vazhdimësi nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 e 81 të KPRK-së (pikat I dhe XIII të dispozitivit) dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 19.12.2016 e deri më datë 19.01.2017, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 3.000 (tremijë) euro. Të dënuarin H.Sh., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit në vazhdimësi nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 e 81 të KPRK-së (pikat IX dhe X të dispozitivit) dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 19.12.2016 e deri më datë 19.01.2017, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) euro. Të dënuarin J.T., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së (pika III e dispozitivit) dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 19.12.2016 e deri më datë 31.12.2016, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) euro. Të dënuarin N.H., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit në vazhdimësi nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 e 81 të KPRK-së (pikat XI e XII, të dispozitivit) dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 19.12.2016 e deri më datë 19.01.2017, si dhe dënim me gjobë në shumë

prej 1.000 (njëmijë) euro. Të dënuarin R.H., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit në vazhdimësi nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 e 81 të KPRK-së (pikat XIV dhe XV të dispozitivit) dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 19.12.2016 e deri më datë 19.01.2017, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) euro. Të dënuarin S.H2., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 e 81 të KPRK-së dhe atë (pikat II, III, XV dhe XVI të dispozitivit) dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 19.12.2016 e deri më datë 19.01.2017, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) euro. Të dënuarin S1.H1., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit në vazhdimësi nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 e 81 të KPRK-së (pikat XIII, XVI dhe XVII të dispozitivit) dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 19.12.2016 e deri më datë 19.01.2017, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) euro. Të dënuarin S.S., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit në vazhdimësi nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 e 81 të KPRK-së (pikat XIV e XVII të dispozitivit) dhe i ka shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 19.12.2016 e deri më datë 19.01.2017, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) euro. Të dënuarin Z.Sh., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së (pika VIII e dispozitivit) dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 19.12.2016 e deri më datë 31.12.2016, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) euro.

Gjykata të dënuarve u ka shqiptuar dënimin plotësues ndalimi i ushtrimit të funksioneve publike, në administratën publike ose shërbimin publik në kohëzgjatje prej nga 3 (tri) vitesh, do të zbatohet pas mbajtjes dhe ekzekutimit të dënimit me burgim.

Të dënuarit janë obliguar që në afat prej 3 (tre) muajve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ti paguajnë dënimet e shqiptuara me gjobë. Në rast se të dënuarit nuk i paguajnë dënimet me gjobë apo nuk mundën ti paguajnë, dënimet me gjobë do t'iu zëvendësohen me dënim me burgim sipas nenit 46 par.3 të KPRK.

Të dënuarve janë obliguar që të paguajnë secili veç e veç paushallin gjyqësor në shumë prej nga 100 (njëqind) €, dhe në Fondin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej nga 50 (pesëdhjetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.405/2021 e datës 08.11.2021, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të dënuarve, ndërsa aktgjykimin e gjykatë së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë ushtruar:

- mbrojtësi i të dënuarit A.H., avokat Mahmut Halimi nga Mitrovica, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal si dhe vendimit lidhur me

dënim, me propozim që Gjykata e Supreme e Kosovës, ti anulojë aktgjykimet e kundërshtuara ti ndryshojë ashtu që duke gjetur se nuk është vërtetuar që i dënuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet për pikat I,II,IV, V, dhe VI të dispozitivit, ta liroi nga aktakuza konform dispozitës së nenit 364 par.1 pika 1.3 e KPPRK, si dhe për veprat e mbetura ti shqiptoi dënim sa më të butë, ose aktgjykimet ti prishë dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, ndërsa në rastin më të pavoritshëm ti shqiptoi një dënim sa më të butë;

- mbrojtësi i të dënuarit A1.B1., av. Tahir Rrecaj nga Prishtina, për shkak të shkeljes së ligjit penal nga neni 385 par.1 të KPPK-së, lidhur me nenin 428 të KPRK-së, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.12, lidhur me nenin 3 të KPPK-së, si shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale nga neni 432 par.1 nënpar.1.3, lidhur me nenin 384 par.2 e nenin 9 të KPPK-së, me ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të rregullt, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoi në tersi si të bazuar kërkesën, ti ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara, ashtu që ta liroj të dënuarin nga akuza, apo të anulojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen t'ia kthej në rigjykim gjykatës së shkallës së parë. Gjithashtu Gjykata Supreme e Kosovës ,në pajtim me dispozitës së nenit 435 par.4 të dënuarit t'ia shtyjë ekzekutimin e dënimit me burg deri në vendosjen definitive lidhur me këtë kërkesë;

- i dënuari A.B., për shkak të shkeljes së ligjit penal - neni 432 par.1 nënpar.1.1 të KPPK, dhe shkeljes se dispozitave të procedurës penale - neni 432 par.1 nënpar.1.1 të KPPK-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoi si të bazuar kërkesën, të ndryshojë aktgjykimet e atakuara apo në tersi ti anulojë aktgjykimet dhe lëndën për gjykim t'ia ktheji gjykatës së shkallës së parë;

- i dënuari A.M., për shkak të shkeljes së ligjit penal (neni 432 par.1 nënpar.1.1 të KPPK), shkeljeve esenciale të ligjit të procedurës penale nga neni 384 par.1 të KPPK-së, si dhe shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore të atakuara (neni 432 par.1 nënpar.1.3 të KPPK), me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoi si të bazuar kërkesën, të ndryshojë aktgjykimet në raport me pikat IV dhe V dhe të më liroi nga akuza lidhur me këto pika, ose në alternativë të anulojë në tersi aktgjykimet e atakuara, ashtu që lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rivendosje;

- i dënuari B.S., për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.12 të KPPK-së, si dhe shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale ku shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të miratoi kërkesë dhe ti anulojë në tërësi aktgjykimet e atakuar dhe lënda t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rivendosje;

- mbrojtësja e të dënuarit E.H1., av. Kada Bunjaku-Përçuku nga Vushtria, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale të KPPK, zbatimit të gabuar të ligjit penal dhe për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që të aprovohet kërkesa si e bazuar dhe të ndryshohen aktvendimet e atakuar, ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza për veprën penale, ose të anulohen aktgjykimet dhe lënda t kthehet në rigjykim, në të kundërtën ti shqiptohet një dënim më i butë duke pasur parasysh edhe praktiken e kësaj gjykate për rastet e ngjashme. Gjithashtu propozon shtyrjen e ekzekutimin të dënimit;

- mbrojtësi i të dënuarit H.Sh., av. Lutfi Tahiri nga Prishtina, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, 370 e lidhur me nenin 3 të KPPRK-së, shkeljes së ligjit penal nga neni 385 të KPPRK, lidhur me neni 428 lidhur me nenin 31 të KPRK, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 386 lidhur me nenin 7 të KPPK-së dhe vendimit mbi sanksionin penal nga neni 387 të KPPRK-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovojë në tersi kërkesën si të bazuar dhe ti ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara ashtu që të dënuarin ta liroj nga akuza, apo ti anulojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim;

- mbrojtësi i të dënuarit J.T., av. Dobrica Llaziq nga Graçanica, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1nëpar.12 të KPPK-së, si dhe shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale ku shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta anulojë aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthejë në rivendosje ose aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë dhe të dënuarin ta liron nga akuza;

- mbrojtësi i të dënuarit N.H., av. Ahmet Tahiri nga Prishtina, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nëpar.1.12 lidhur me nenin 370 par.6 dhe 7 par.2, lidhur me nenin 3 par.1 e 2 të KPPRK-së, shkeljes së ligjit penal nga neni 385 par.1 lidhur me nenin 428 e nenin 31 të KPPRK-së, vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 386 par.2 lidhur me nenin 7 të KPPRK, si dhe vendimit mbi sanksionin penal nga neni 387 të KPPRK-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovojë në tersi kërkesën si të bazuar, ti ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara ashtu që të dënuarin ta liroi nga akuza, ashtu që aktgjykimet e kundërshtuara ti anulojë dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rivendosje;

- mbrojtësi i të dënuarit R.H., av. Visar Rrecaj nga Prishtina, për shkak të shkeljes së ligjit penal nga neni 385 par.1 të KPPK-së, lidhur me nenin 339 par.1 të KPRK-së, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nëpar.1.8 e 1.12, lidhur me nenin 370 par.6 e 7, nenit 384 par.2, lidhur me nenin 390 par.1 e nenit 3 par.1, nenit 5 par.1 dhe nenit 9 par.1 të KPPK-së, si shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale nga neni 432 par.1 nëpar.1.3, lidhur me nenin 384 par.2 të KPPK-së, me ndikim në marrjen e aktgjykimet të ligjshëm dhe të rregullt, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoi në tersi si të bazuar kërkesën, ti ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara, ashtu që të liroj të dënuarin nga akuza, apo të anulojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen t'ia ktheji në rigjykim gjykatës së shkallës së parë;

- mbrojtësi i të dënuarit S.H2., av. Shefqet Ibrahimimi nga Skenderaj, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike si dhe vendimit lidhur me sanksionet penal, me propozim që Gjykata e Supreme e Kosovës, ti anulojë aktgjykimet e atakuara dhe lëndën t'ia ktheji gjykatës së shkallës së parë në rigjykim;

- mbrojtësi i të dënuarit S1.H1., av. Kadri Osaj nga Mitrovica, për shkak të shkeljes së ligjit të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që të aprovohet kërkesa, apo

aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, ose ti ndryshojë aktgjykimet dhe të dënuarin ta shpallë të pafajshëm;

- mbrojtësi i të dënuarit S.S., av. Mile Marković nga Graçanica, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale ku shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta anulojë aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthejë në rivendosje ose aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë dhe të dënuarin ta liron nga akuza;

- i dënuari Z.Sh., për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të ligjit të procedurës penale dhe shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën si të bazuar, duke e ndryshuar vendimin e formës së prerë dhe të bie aktgjykim lirues, apo lëndën ta kthejë në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.II.nr.76/2022 e datës 01.04.2022, ka propozuar që të refuzohen si të pabaza kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve: S.H2., av. Shefqet Ibrahim, A1.B1., av. Tahir Rrecaj, E.H1., av. Kada Bunjaku-Përçuku, H.Sh., av. Lutfi Tahiri, S.S., av. Mile Marković, A.H., av. Mahmut Halimi, N.H., av. Ahmet Tahiri, R.H., av. Visar Rrecaj, S1.H1., av. Kadri Osaj, J.T., av. Dobrica Llaziq, dhe të dënuarve A.B., Z.Sh., B.S. dhe A.M..

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e çështjes konform dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë konstatoi se:

- kërkesat e mbrojtësve të të dënuarve si dhe të dënuarve, janë të pabazuara

Mbrojtësit e të dënuarve dhe të dënuarit aktgjykimet i kundërshtojnë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale duke pretenduar se aktgjykimet janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1, nënpar.1.8, e nënpar.1.12 dhe par.2, nënpar.2.1 lidhur me nenin 370 të KPPK-së, pasi që veçanërisht në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk janë paraqitur arsyet për faktet vendimtare përkitazi me veprat penale që pretendohen se janë kryer nga ana e të dënuarve. për më tepër, theksohet se arsyetimi i paraqitur është i paqartë, kundërtshënës me vetveten dhe i pakuptueshëm.

Në kërkesat e tyre mbrojtësit dhe të dënuarit theksojnë se aktgjykimet nuk përmbajnë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare për vendosjen e çështjes, kurse arsyet e paraqitura janë në kundërshtim me përmbajtjen e provave materiale dhe të shkresave të lëndës dhe në këtë mënyrë gjykata e shkallës së parë nuk i ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i ka konsideruar si të vërtetuara, në raport me të dënuarit si dhe cilat janë ato veprime të cilat do të përmbushnin figurën e veprës penale të marrjes së ryshfetit si dhe nuk arsyetohet asnjë rrethanë se kush ishte dhënësi apo a ka palë të dëmtuar në këtë çështje penale.

Shkelja tjetër esenciale e dispozitave të procedurës penale sipas mbrojtësve të të dënuarve dhe të dënuarve konsistojnë në shkeljen e nenit 384 par.1, nënpar.1.8, sepse aktgjykimi bazohet në prova të papranueshme, nga fakti se i gjithë aktgjykimi është bazuar në video incizimet nga kamerat e përgjimeve të vendosura në automjetet zyrtare dhe transkriptet e shkruara dhe të cilat janë nxjerrë bazuar në incizimet. Kjo provë sipas mbrojtësve dhe të dënuarve nuk është marrë në mënyrë të ligjshme për arsye se urdhëresa për aplikimin e masës së fshehtë nuk është marrë në pajtim me dispozitën e nenit 92 par.1 nënpar.1.3 të KPPK-së, pasi që ligjdhënësi ka paraparë që me rastin e lëshimit të masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit të shënohet emri dhe adresa e personit apo personave që i nënshtrohen urdhrit si dhe baza ligjore e saktë e saj, e në rastin konkret urdhëresa e lëshuar nuk përmban as emrin e as adresën e po ashtu as të dhëna të tjera të parapara me nenin 92 të KPPK-së.

Në kërkesa pretendohet se në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë përshkrimi i veprës penale kundër të dënuarve nuk është i drejtë sepse në të nuk janë dhënë faktet dhe elementet që e përbëjnë figurën e kësaj vepre penale. Në veçanti nuk janë përshkruar veprimet e të dënuarve, nuk është konstatuar se cili ishte aktiviteti i përbashkët i tyre dhe veçanërisht atakohet kontributi thelbësor apo kauzal si dhe aspektet e bashkëkryerjes, përkatësisht ekzistimi i marrëveshjeve paraprake mes kryerësve të këtyre veprave penale.

Gjithashtu në kërkesat e tyre është theksuar se në rastin konkret është shkelur ligji penal nga neni 385 par.1 nënpar.1.5 i KPPK-së, ndërsa sa i përket vendimit mbi dënim konsiderojnë se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit nuk ka bërë individualizimin e dënimit përkatësisht dënimi nuk është peshuar sa duhet ngase nuk janë marrë për bazë rrethanat lehtësuese por vetëm ato rënduese. Për më tepër, pretendohet se si rrethana rënduese janë vlerësuar elementet e veprës penale dhe atë dashja, motivi, vazhdimësia e veprimit dhe faktorë tjerë.

Specifikisht në kërkesën e të dënuarit B.S. dhe mbrojtësit të të dënuarit N.H., potencohet fakti se gjykata e shkallës së parë ka bërë interpretim të gabuar të dispozitës ligjore të nenit 126 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së pasi që nuk ka dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit D.Rr., përkundër faktit se ndaj tij ishte pushuar procedura penale.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vlerësuar pretendimet nga kërkesat e paraqitura si dhe duke u bazuar në shkresat e çështjes gjeti se arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë përmban konkludime të qarta dhe gjetjet e saj nuk kanë kundërthënie as me vetveten as me arsyetimin e tyre. Në arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë janë të paraqitura të gjitha arsyet e duhura faktike dhe juridike mbi bazën e të cilave është marrë vendimi e të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë. Në arsyetim janë dhënë arsye të mjaftueshme ligjore lidhur me të gjitha provat e administruara në shqyrtimet gjyqësore duke vënë në dukje se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i merr të provuara ose si të paprovuara dhe duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore e konform dispozitës së nenit 370 par.7 të KPPK-së. Bazuar në shkresat e lëndës vërtetohet fakti se aktgjykimi mbështetet në provat materiale dhe veçanërisht materialet e nxjerra nga video incizimet e siguruarat përmes masave të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit, oraret ditore të punës, listat patrulluese, evidencat e aktiviteteve patrulluese dhe raportet e transkriptimit

të nxjerra përmes video incizimeve, gjykata e shkallës së parë ka konkluduar se është vërtetuar në tërësi pretendimi i prokurorisë përkitazi me veprimet inkriminuese të të dënuarve.

Përtej kësaj arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë është përmbajtjesor në trajtimin e të gjitha provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, ndonëse pa dyshim se kanë dominuar incizimet përmes masave të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit. Fakti se aktgjykimi bazohet në video incizime në asnjë rrethanë nuk e zbeh arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë, përkundrazi nga shkresat e lëndës del se në rastin konkret nuk janë paraqitur të dhëna kontradiktore që do ti vënin në pikëpyetje provat e siguruar përmes video incizimeve.

Në këtë kontest i rëndësishëm është të theksohet fakti se shumica e të dënuarve kanë zgjedhur mënyrën e mbrojtjes në heshtje dhe atë në të gjitha fazat e procedurës penale, andaj edhe nuk ka pasur mundësi të vlerësimit të versionit të tyre të mbrojtjes. Megjithatë në faqen e 74 të aktgjykimit të saj gjykata e shkallës së parë ka dhënë vlerësime përkitazi me mbrojtjen e dhënë nga ana e të dënuarve B.S. dhe R.H. gjatë shqyrtimit gjyqësor, kurse për të dënuarit tjerë E.H1., J.T., S.H2., S1.H1. dhe S.S., për mbrojtjen e tyre të paraqitur gjatë procedurës hetimore. Ashtu që në këtë mënyrë gjykata e shkallës së parë mbrojtjen e tyre e ka vlerësuar si të pabesueshme dhe në kundërshtim me të gjitha provat e administruara, pra nga kjo rrjedh se ky pretendim ishte i pabazuar.

Përkitazi me pretendimin se nga përshkrimi faktik e as nga përmbajtja e arsyetimit të aktgjykimit nuk dihet identiteti i të dëmtuarve, pikërisht kush janë dhënësit e ryshfetit e as shuma e saktë të cilën pretendohet se e kanë pranuar të dënuarit edhe kjo gjykatë vlerëson se do të ishte mirë që të dihet se kush është dhënësi i ryshfetit dhe shuma e saktë, mirëpo duke pasur parasysh rrethanat e rastit konkret, sidomos faktin se objekt i kontrollit nga patrullat policore (tani të dënuar) ishte një numër i madh i vozitësve të veturave që kalonin në rrugë dhe përmbajtjen e incizimeve nga CD e përmendura, të administruara si prova, edhe në mungesë të identitetit të dhënësit të ryshfetit padyshim vërtetohen veprimet e secilit të dënuar veç e veç, qoftë si kryerës aktiv apo pasiv (policët që kanë komunikuar me kundërvajtësit apo ata që kanë vëzhguar duke matur shpejtësinë apo plotësuar tiketat), veprime këto që në rastin konkret edhe i bëjnë bashkëkryerës sepse tek ata ka ekzistuar dashja dhe veprimi i përbashkët për t'i ndërmarrë veprimet inkriminuese.

Gjykata e shkallës së parë pretendohet se nuk ka arritur të arsyetoj bindshëm aktgjykimin me të cilin janë shpallur fajtor të dënuarit për vepër penale të marrjes së ryshfetit, se sa ka qenë vlera që të dënuarit e kanë pranuar nga kundërvajtësit, në sa ora i kanë pranuar ato, me cilën datë, në cilin vend, mënyrën e pranimit, identifikimin e kundërvajtësve, dëgjimin e dëshmitarëve që në rastin konkret nuk ka pasur asnjë dëshmitar sepse sipas tyre është dashur të dëgjohen ndonjëri nga kundërvajtësit në cilësi të dëmtuarve, por këta kundërvajtës kanë mbetur të panjohur, të pa identifikuar, andaj, në rastin konkret një person nuk mund të shpallet fajtor për marrje të ryshfetit pa u ditur identiteti i dhënësit të ryshfetit kur dihet se edhe dhënia e ryshfetit është vepër penale e dënueshme. Më tutje vazhdohet me pretendimet se nga transkriptet e siguruar të cilat janë dëgjuar, askund nuk flitet se të dënuarit kanë përmendur para dhe se tërësia e ngjarjeve bazohet në biseda ku thuhet se nuk dëgjohet se çka po flitet dhe se nuk shihet se çka kanë në dorë të dënuarit, duke supozuar se ato janë kartëmonedha dhe si të tilla këto janë prova të pa pranueshme

deri sa nuk janë të konfirmuara, ngase këto mund të kenë qenë edhe dokumente të veturave të cilat të dënuarit i kanë ndalur.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e mësipërme nuk janë të bazuara. Faktet vendimtare që i ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë me asgjë nuk vihen në dyshim. Në rastin konkret nuk vihet në dyshim konkludimi i gjykatës së shkallës së parë, meqë nuk ofrohet asnjë provë, asnjë fakt që do të shpinte në vërtetimin e faktit se të dënuarit nuk janë kryes të veprave penale që ju vihet në barrë. Ligjshmëria e provave të siguruara nga zbatimi i masave të fshehta është trajtuar në pjesën e aktgjykimit që i referohet bazës ankimore nga neni 384 të KPPK-së, përkatësisht kërkesave që i referohet shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe kjo gjykatë nuk e sheh të nevojshme që ta përsërisë edhe një herë. Nga shikimi i arsytimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë rezulton se gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike e mbështetë në CD video dhe audio incizimeve nga vendi i ngjarjes të siguruara nga zbatimi i masave të fshehta të urdhëruara nga gjykata dhe në orarin ditor dhe raportin e punës për secilin të dënuar veç e veç. Nga shikimi i aktgjykimit del se gjykata e shkallës së parë qartë dhe në mënyrë detaje ka paraqitur përmbajtjen e këtyre provave (CD video dhe audio incizimet por edhe orarin e punës) për secilin të dënuar duke iu referuar datës kur janë incizua pamjet që përmban CD, si dhe kohës dhe veprimet konkret të të dënuarve.

Në arsytimin e aktgjykimit janë paraqitur qartë dhe detajisht faktet që vërtetohen nga orari i punës të të dënuarve në kohën kontestuese, pikërisht veturat që i kishin në dispozicion të dënuarit, por edhe përbërja e ekipit (patrullës), fakte këto që nuk u kontestuan me ndonjë provë konkrete.

Nga orari ditor i punës i Drejtorisë Rajonale të Policisë dhe Raporti i patrullës së Njësisë Rajonale të trafikut vërtetohet se të dënuarit në vazhdimësi pasi që kanë ndaluar drejtuesit të veturave dhe pasi që kanë komunikuar me ta u kanë shpjeguar kundërvajtjen e kryer dhe dënimin i cili mund tu shqiptohet dhe me këtë rast në mënyrë të qartë është specifikuar data dhe koha kur të dënuarit kanë marrë shuma të parave me qëllim që ndaj drejtuesve kundërvajtës të mos shqiptojnë tiketa përkatësisht dënime për kundërvajtje. Në arsytimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë konkretisht është përshkruar përfitimi por edhe fakti se të dënuarit në datat e përcaktuara ishin në detyrë si në vijim: për datën 23.09.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police 118-04 në ndërrimin e pasdites prej orës 08:00 deri në ora 16:00 kanë qenë të dënuarit A.H. dhe E.H1.; për datën 24.09.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police 130-04 në ndërrimin e paradites prej orës 08:00 deri në ora 16:00 kanë qenë të dënuarit A.H. dhe S.H2.; për datën 29.09.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police 130-04 në ndërrimin e pasdites prej orës 16:00 deri në ora 00:00 kanë qenë të dënuarit A.H., S.H2. dhe J.T.; për datën 30.09.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police 083-04 në ndërrimin e pasdites prej orës 16:00 deri në ora 00:00 kanë qenë të dënuarit A.H. dhe A.M.; për datën 12.10.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police 083-04 në ndërrimin e paradites prej orës 08:00 deri në ora 16:00 kanë qenë të dënuarit A.H. dhe A.M.; për datën 10.10.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police 083-04 në ndërrimin e natës prej orës 00:00 deri në ora 08:00 kanë qenë të dënuarit A.H. dhe A.B.; për datën 17.10.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police 083-04 në ndërrimin e pasdites nga ora 00:00 deri në ora 08:00 kanë qenë të dënuarit A.H. dhe

A.B.; për datën 14.10.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police 130-04 në ndërrimin e pasdites prej pres 00:00 deri në ora 08:00 kanë qenë të dënuarit A.H. dhe Z.Sh.; për datën 04.11.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police 118-04 në ndërrimin e paradites prej orës 08:00 deri në ora 16:00 kanë qenë të dënuarit A.H. dhe H.Sh.; për datën 25.09.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police 118-04 në ndërrimin e pasdites prej orës 16:00 deri në ora 00:00 kanë qenë të dënuarit H.Sh. dhe A1.B1.; për datën 12.10.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police 083-04 në ndërrimin e pasdites prej orës 16:00 deri në ora 00:00 kanë qenë të dënuarit B.S. dhe N.H.; për datën 02.11.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police 118-04 në ndërrimin e paradites kanë qenë të dënuarit B.S dhe N.H.; për datën 30.09.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police 130-04 në ndërrimin e pasdites prej orës 16:00 deri në ora 00:00 kanë qenë të dënuarit E.H1. dhe S1.H1.; për datën 01.10.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police 118-04 në ndërrimin e paradites prej orës 16:00 deri në ora 00:00 kanë qenë të dënuarit R.H. dhe S.S.; për datën 15.10.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police 130-04 në ndërrimin e paradites prej orës 08:00 deri në ora 16:00 kanë qenë të dënuarit R.H. dhe S.H2.; për datën 18.10.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police 083-04 në ndërrimin e pasdites prej orës 16:00 deri në ora 00:00 kanë qenë të dënuarit S.H2. dhe S1.H1. dhe për datën 10.10.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police 118-04 në ndërrimin e pasdites prej orës 16:00 deri në ora 00:00 kanë qenë të dënuarit S1.H1. dhe S.S.

Nga shikimi i CD-ve të bashkangjitura shkresave të lëndës dhe të administruara si prova në shqyrtimin gjyqësor, vërtetohen faktet se të dënuarit kanë vepruar në mënyrën si është precizuar edhe në përshkrimin faktik të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar. Pra, nga këto pamje por edhe nga audio incizimi pa dyshim vërtetohet se në mes të dënuarve dhe dhënësve të ryshfetit ka pasur një marrëveshje të heshtur për shkëmbim shërbimesh. Në fakt, pasi që të dënuarit i ndalojnë kundërvajtësit, u komunikojnë shkeljen dhe dënimin e përcaktuar me ligje për kundërvajtje, në disa raste i pranojnë parat në emër të pagesës për mos shqiptimin e gjobave, përkatësisht nuk i plotësojnë tiketat e trafikut, gjegjësisht në disa raste për mos plotësimin e tiketave pranojnë të holla si dhuratë nga kundërvajtësit të cilat ua japin në dorë ose i lënë në veturë dhe të cilat pastaj të dënuarit i ndajnë në mes veti. Pra nga këto fakte pa dyshim vërtetohet lidhja shkakësore në mes dhuratës së marrë dhe veprimit të paligjshëm, gjegjësisht mosveprimit në pajtim me detyrën e tyre zyrtare.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimet e kundërshtuar mbështeten në prova të papranueshme, konkretisht në video dhe audio incizimit të siguruar nga masat e fshehta dhe transkriptet e bisedave të nxjerra nga këto CD. Në fakt, bazuar në shkresat e lëndës del se gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike e mbështetë përveç tjerash edhe në CD e video dhe audio incizimit të siguruar nga masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit të cilat janë zbatuar në mënyrë të ligjshme sipas urdhëresës të lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda me nr.41/2016 të datës 20.09.2016 në kuptim të nenit 91 par.2 nënpar.2.1 dhe 2.2 të KPPK-së. Gjykata e shkallës së parë urdhrin e përmendur e ka lëshuar pas kërkesës të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë N-I-nr.170/2016 të datë 19.09.2016. njëkohësisht duke përcaktuar monitorimin, vëzhgimin ose incizimin e

personave, lëvizjet e tyre, aktivitet e tyre nga zyrtari policor përmes fotografimit ose me video mjete-kamera dhe atë në veturat zyrtare: Golf V, ngjyrë hiri, me targa “Police 118-04”, Golf V, ngjyrë hiri, me targa “Police 130-04” dhe Golf V, ngjyrë hiri, me targa “Police 083-04”. Në këtë kontekst vlen të theksohet fakti se urdhri kishte afat prej 60 ditësh nga datat e lëshimit dhe se të gjitha inkriminimet ligjore të të dënuarve mbulojnë periudhën kohore të lesimit të këtij urdhri.

Kurse me dispozitën e nenit 88 par.2 dhe 3 nënpar.2.1,2.3,3.1 dhe 3.2 të KPPK-së, është përcaktuar se nevojiten dy kushte të domosdoshme për të lëshuar masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit të cilat janë zbatuar dhe atë së pari të ekziston dyshimi i bazuar se vendi apo sendi përdoret për kryerjen e veprës penale dhe informacioni të mos mund të merrej me veprime tjera hetimore. Në rastin konkret sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, të dy kushtet ligjore janë plotësuar në tërësi dhe e para se ka ekzistuar dyshimi i bazuar se veturat e policisë janë përdorur për kryerjen e veprës penale dhe se në rastin konkret duke marrë parasysh mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale nuk kishte ndonjë mundësi tjetër për të zhvilluar një hetim të zakonshëm pos me lëshimin e masave të tilla, dhe për më tepër, në urdhëresën e lëshuar nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake janë arsyetuar të gjitha aspektet e kërkuara ligjore.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet se gjykata i ka shpall fajtor të dënuarit duke u mbështetur vetëm në një provë janë të pabazuara, ngase del se gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e mbështetë në provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, konkretisht CD-të që përmbajnë video dhe audio incizimet të siguruar nga zbatimi i masave të fshehta të urdhëruara në pajtim me dispozitat e KPPK-së, nga gjykata kompetente. Duke u bazuar në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë del se aktgjykimi bazohet edhe në oraret ditore të punës - fletat patrulluese të Drejtorisë Rajonale të Policisë në të cilat është vërtetuar se të dënuarit kanë përdorur automjetet zyrtare të policisë Golf V, ngjyrë hiri, me targa “Police 118-04”, Golf V, ngjyrë hiri, me targa “Police 130-04” dhe Golf V, ngjyrë hiri, me targa “Police 083-04”, dhe për më tepër, secili raport ditor i punës është në përputhje të plotë me incizimin përmes CD dhe transkriptet e bisedave të zhvilluara, ashtu që nga kjo rezulton se pretendimi i theksuar në kërkesa se aktgjykimi bazohet vetëm në një provë nuk është i bazuar.

Mbrojtësit e të dënuarve dhe të dënuarit në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendojnë se shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike ka ndikuar që me shpalljen fajtor të dënuarve për veprat penale marrje e ryshfetit nga neni 428 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, është shkelur ligji penal në dëm të tyre sepse me asnjë provë nuk është vërtetuar se veprimet e të dënuarve përbëjnë elementet subjektive dhe objektive të kësaj vepre penale. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës në këtë çështje penale ashtu siç me të drejtë është konstatuar nga ana e dy gjykatave të instancave më të ulëta se në veprimet e të dënuarve janë realizuar të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, meqë në vend, kohë dhe mënyrë siç është përshkruar në dispozitivet përkatëse të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjithashtu është theksuar se të dënuarit duke vepruar në kuadër të autorizimeve të tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë kërkuar para me qëllim që të mos veprojnë në kuadër të autorizimeve të tyre zyrtare dhe në cilësinë e personave zyrtar përkatësisht zyrtarëve policor në njësitin e kontrollit të autostradave, kanë pranuar të holla me qëllim që të mos

shqiptojnë tiketa të trafikut kundërvajtësve dhe me këtë rast shumat e parave i kanë ndarë në mënyrë proporcionale. Me këtë rast është e qartë se bëhet fjalë për persona zyrtar pasi që të dënuarit kanë pasur cilësi të personit zyrtar dhe se veprimet e tyre i kanë ndërmarrë në kuadër të autorizimeve të tyre zyrtare. Fakti se të dëmtuarit të cilët kanë dhënë para përkatësisht ryshfet nuk janë identifikuar dhe nuk janë të dëgjuar në cilësi të të dëmtuarve nuk e cenon aspektet inkriminuese të veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor dhe janë gjykuar të dënuarit.

Për ekzistimin e veprës është e parëndësishme nga kush ka rrjedhë iniciativa për ryshfet nga dhënësi apo nga marrësi i ryshfetit dhe kjo vepër është e kryer në momentin e pranimin të ryshfetit (pa marr parasysh vlerën) dhe po ashtu është irelevante fakti se personat që kanë dhënë ryshfet nuk janë identifikuar me emër dhe mbiemër, pasi që në rastet konkrete e rëndësishme është se të hollat ishin dhënë me qëllim që personat zyrtarë përkatësisht zyrtarët policor nuk kanë vepruar në kuadër të kompetencave të tyre.

Sa i përket pretendimeve të ngritura përkitazi me dënimin e shqiptuar, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit ka zbatuar drejt edhe dispozitat e ligjit penal dhe të dënuarve ka shqiptuar dënime brenda kornizës së përcaktuar të dënimit për këto vepra penale bazuar në dispozitën e nenit 428 par.1 të KPRK-së. Gjykata e shkallës së parë, në faqet 75-77 të arsyetimit të aktgjykimit të saj, ka arsyetuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që kanë ndikuar për të përcaktuar llojin dhe lartësinë e dënimit e bindur se me anë të këtyre dënimeve është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale. Është në diskrecion të gjykatës së shkallës së parë që të shqiptoj llojin dhe lartësinë e dënimit bazuar në mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe kontributit të secilit kryes, mirëpo e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkaluar kompetencat ligjore.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstaton se konform dispozitës së nenit 385 par.5 të KPPK, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënim, dënimi alternativ, vërejtja gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar llojin e dënimit të paraparë për këtë vepër penale gjegjësisht dënimin me burgim brenda minimumit dhe maksimumit të paraparë me ligj, kështu që pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve dhe të dënuarve të paraqitura në kërkesë se aktgjykimi është i përfshirë në shkelje të ligjit penal nuk ishte i bazuar.

Duke vlerësuar pretendimet e të dënuarit B.S. dhe mbrojtësit të të dënuarit N.H., Gjykata Supreme e Kosovës është plotësisht dakord me kërkesat e parashtruara se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka interpretuar dispozitën e nenit 126 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, pasi që ndaj dëshmitarit të propozuar D.Rr., rrjedh se procedura ka pushuar përkundër faktit se ka qenë i akuzuar për pikën XI dhe XII të aktakuzës, pasi që dispozita në fjalë zbatohet deri sa zhvillohet procedurë e përbashkët, kurse në rastin konkret ndaj të pandehurit D.Rr., ishte pushuar procedura penale dhe me këtë ishte krijuar mundësia e dëgjimit të tij në cilësi të dëshmitari, kurse aspektet

e vlerës provuese dhe besueshmërisë së dëshmisë së tij do të vlerësoheshin pas dëgjimit të tij. Mirëpo përkundër kësaj, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës dëgjimi i këtij dëshmitari nuk do të kishte ndikim në epilogun e kësaj çështje penale përkitazi me këta të dënuar.

Edhe pse kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë paraqitur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal, megjithatë bazuar në përmbajtjen e kërkesave të mbrojtësve dhe të dënuarve, por edhe në kërkesa janë potencuar pretendime edhe përkitazi me konstatimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Mirëpo, këto pretendime janë refuzuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, meqë bazuar në dispozitën e nenit 432 par.2 të KPPK-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 437 dhe nenit 435 par.2 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.127/2022, më 26 prill 2022

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka